

**AKT THEMELIMI  
DHE STATUTI I SHOQËRISË  
DATALYTICS HUB Sh.p.k.**

Sot, më 13.11.2024, unë e nënshkruara **Dorina Lamlli**, shtetase shqiptare, atësia Enver, lindur më 27.04.1995, në Fushë Krujë, banuese në adresën Rruga "Asim Vokshi", Hyrja 1, Apartamenti 4, Zona Kadastrale 8360, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e dokumentit letërnjoftim me numër 037321289 dhe numër personal J55427067Q, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Në përputhje me ligjin 9910, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (l ndryshuar) dhe ligjit 9723, datë 03.05.2027, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (l ndryshuar", themeloj një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar si me poshtë vijon dhe miratoj statutin e kësaj shoqërie.

**KREU I**

**EMËRTIMI -SELIA -OBJEKTI -KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**Emërtimi**

1.1 Shoqëria emërhohet "**Datalytics Hub**" (në vijim referuar si "Shoqëria").

1.2 Emërtimi i Shoqërisë ndiqet nga akronimi "Sh.p.k.", sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar (në vijim referuar si "Ligji Tregtar") në përputhje me formën e saj juridike, sipas nenit vijues.

1.3 Shoqëria ka logon dhe vulën përkatëse, të cilat vendosen në cdo dokument të saj.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

2.1. Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

2.2. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislatin shqiptar në fuqi dhe me këtë Statut.

**Neni 3**

**Selia**

3.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

Rruga "Asim Vokshi", Hyrja 1, Apartamenti 4, Zona Kadastrale 8360, Tiranë, Shqipëri.



3.2. Administratori/ët mund të hapë/in dhe/ose mbyllë/in degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat do të ushtrojnë veprimtarinë sipas kompetencave dhe kufizimeve të vendosura nga Ortaku i Vetëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

4.1. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

4.2. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të percaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

4.3. Shoqëria mund të prishet gjithashtu për shkaqe ligjore, të pavarura nga vuilneti i Ortakut të Vetëm.

#### Neni 5

##### Objekti i Veprimtarisë

5.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:

- I. Kurse të formimit profesional për platformat software për nivele të ndryshme (analist, përdorues, zhvillues, trajnues, etj.). Kurse të formimit profesional për sisteme ICT, aplikacione, menaxhim projekteve, menaxhim procesesh dhe cilësie, etj.
- II. Kurse të formimit profesional dhe asistencë teknike në fushën e turizmit, energjisë, zhvillimit të qëndrueshëm, etj; asistencë teknike në implementimin e proceseve operacionale që janë në linjë me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, ESG dhe të kuadrit ligjor të BE.
- III. Asistencë teknike në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, teknologjike dhe operacionale të shoqërive të ndryshme; asistencë teknike për gjetjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore; asistencë teknike në hartimin e procedurave dhe manualeve të shoqërive të ndryshme; zhvillim i kapaciteteve të tē rinxve dhe ofrimi i ndërlidhjes me tregun e punës; analiza statistikore, studime tregu dhe vlerësimë ekonomike.
- IV. Shërbime dhe konsulencë e thelluar në fushat e tranzicionit digital, ndryshimi në menaxhim, ndryshimi në komunikim, transformimi digital, trajnimi për procese dhe software, vlerësimi i gatishmërisë për ndryshim, menaxhimi i projekteve, design thinking, ndryshimi i qëndrueshëm, rezistenca ndaj ndryshimit, etj. Shërbime të marketingut digital, dizajni grafik, zhvillim dhe mirëmbajtje të faqeve web.
- V. Shoqëria mund të themelojë apo zotërojë pjesëmarrje, të bashkëpunojë, të lidhi marrëveshje joint venture a marrëveshje të ngashme me shoqëri që kanë objekt të njëjtë apo lidhur me objektin e saj.

5.2. Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose të nevojshme të lejuara nga legjislacioni në fuqi, për realizimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.



5.3. Objekti i veprirntarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, përditësohet, plotësohet në cdo moment, me vendim të Ortakut të Vetëm.

## KREU II

### KAIPITALI DHE KUOTA

#### Neni 6

##### Kapitali

6.1. Kapitali i Shoqërisë është 10.000,00 (dhjetë mijë) lekë,

6.2. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, në përputhje me nenin 7 vijues.

#### Neni 7

##### Ortaku i Vetëm

7.1. Ortaku I Vetëm i Shoqërisë është:

**Dorina Lamlli**, shtetase shqiptare, atësia Enver, lindur më 27.04.1995, në Fushë Krujë, banuese në adresën Rruga "Asim Vokshi", Hyrja 1, Apartamenti 4, Zona Kadastrale 8360, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e dokumentit letërnjoftim me numër 037321289 dhe numër personal J55427067Q, zotëruese e 1 (një) kuote që i korrespondon 100% të kapitalit themeltar në shumën prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh.

#### Neni 8

##### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Li. Kapitali I Shoqerisë mund të zmadhohet në cdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.

8.2. Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në cdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e vlerës së kapitalit të kërkuar nga Ligji Tregtar.

8.3. Kontributi I mëtejshëm i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, kuota apo të drejta). Mënyra e shiyerjes së kontributeve do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### Neni 9

##### Transferimi i Kuotës

9.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë në cdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legislacioni në fuqi.

9.2. Ne rastet e kalirnit të kuotave me kontratë, Ortaku i Vetëm përcakton kushtet, momentin e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, momentin e pagesës së çmimit, në kontratën e kalimit të kuotës, e cila hartohet në formë shkresore, sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

### KREU III

#### ORGANIZIMI I SHOQERISË

##### Neni 10

###### Organet e Shoqërisë

10.1. Organet e Shoqorisë janë si vijon:

- Ortaku i Vetëm — organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori/ët — organi më i lartë ekzekutiv.

### KREU IV

#### VENDIMMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

##### Neni 11

###### Vendimmarrja

11.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

11.2. Ortaku i Vetëm merr vendime për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat e Shoqërisë, në çdo moment.

11.3. Ortaku i Vetem është përgjegjës ndër të tjera, përvendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
- Ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndajen e kompetencave të tyre, si dhe shpérblimin përkatës;
- Përcaktimin e procedurave të mbledhjes së administratorëve përmarijen e vendimeve lidhur me administrimin e Shoqërisë;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël dhe likuiduesve dhe shpérblimin e tyre;
- Perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;



- h. Zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
- i. Pjesëtimin dhe transferimin e kuotës;
- j. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- k. Shpërndarjen e fitimeve;
- l. Riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
- m. Cdo cështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

### **Neni 12**

#### **Regjistri i Vendimeve**

12.1. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

12.2. Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet e me poshtme:

- a. Mmiratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- b. Shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
- c. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- d. Vendime në lidhje me investimet;
- e. Riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

12.3. Lista e mësipërme nuk është shteruese. Vendime të tjera të Ortakut të Vetëm mund të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve.

12.4. Vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve janë absojutisht të pavlefshme. Gjiihesi, Shoqëria nuk mund të kundërshtojë pavlefshmerine të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèc rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

13.1. Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë, numri dhe kompetencat e të cilëve do të përcaktohen me vendim nga Ortaku i Vetëm.

13.2. Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.

13.3. Administratori/ët zgjidhen në përputhje me kërkesa ligjore dhe kufizimet e Ligjit Tregtar,



13.4. Administratori/ët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë.

13.5. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pese) vjeçar.

13.6. Kohëzgjatja e mandatit të administratorit/ëve mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm, pa kufizim.

13.7. Administratori/ët mund të heqin dorë në cdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Ortakut të Vetëm, i cili duhet të caktojë një administrator të ri apo të ndajë kompetencat ndërmjet administratorëve të mbetur (në rastin kur Shoqëria ka disa administratorë).

13.8. Dorëheqja e administratorit/ëve nuk cënon paditë e Shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori/ët kanë ndaj saj, sipas legjislacionit të zbatueshëm.

13.9. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **Dorina Lamlli**, lindur më 27.04.1995, mbajtëse e dokumentit letërnjoftim me numër 037321289 dhe numër personal J55427067Q.

13.10. Mandati i Administratorit të parë të Shoqërisë do të jetë 5 vjet.

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratorit

14.1. Administratori/ët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimet e Ortakut të Vetëm dhe legjislacionin e zbatueshëm.

14.2. Kompetencat dhe detyrat e administratorit/ëve në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:

- a. Zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut te Vetëm;
- b. Kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
- c. Sigurimin e mirëmbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
- d. Sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
- e. Përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat paraqiten përpara Ortakut të Vetëm përmiratim;
- f. Raportojnë përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizirnin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- g. Përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- h. Njoftojnë Ortakun e Vetëm menjëherë për cdo çeshtje që kërkon vendimmarrjen e tij;

i. Kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;

j. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dhe

k. Kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.

14.3. Administratori/ët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.

14.4. Ortaku i Vetëm përcakton, me vendim përkatës, kufizimet e kompetencave, objektin e kompetencave për secilin administrator dhe, nëse është e nevojshme, procedurat për mbledhjet e administratorëve.

14.5. Në rast caktimi të më shumë se një administratori, Ortaku i Vetëm përcakton me vendim ndarjen e kompetencave ndërmjet tyre, kompetencat të cilat ushtrohen veçmas dhe kompetencat të cilat ushtrohen bashkërisht nga më shumë se një administrator.

14.6. Ndryshimet dhe kufizimet në administrimin e Shoqërisë si më sipër, nuk do të konsiderohen si ndryshim i Statutit të Shoqërisë.

14.7. Administratori/ët mund të veprojë vetëm duke marë parasysh interesin me të lartë të Shoqërisë.

14.8. Administratori/ët mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjerë.

14.9. Administratori/ët informojnë Ortakun e Vetëm për ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vërë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe cdo dokument tjetër të brendshëm të Shoqërisë.

14.10. Administratori/ët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjeshtëri ruajtjes së informacionit konfidencial, të ushtrojnë kompetencat që u njihen në legjislacionin e zbatueshëm ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në dispozitat e Ligjit Tregtar, të vlerësojnë me përgjegjësi çeshtjet, për të cilat merret vendim, të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë, të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

14.11. Nëse administratori/ët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standarde profesionale, sipas parashikimeve të këtij Statuti, rregulloreve të posaçme të miratuara nga Ortaku i Vetëm dhe nga legjislacioni i zbatueshëm. Ata janë të detyruar t'i dëmshpérblejnë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

14.12. Administratori/ët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga me shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.



**KREU V**

**DISPOZITAT E FUNDIT**

**Neni 15**

**Eksperti Kontabël i Autorizuar**

15.1. Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënavë kontabël të Shoqërisë do tu besohet një ose më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

**Neni 16**

**Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare**

16.1. Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të cdo viti.

16.2. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar.

**Neni 17**

**Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë**

17.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do lë shoqérohet me procedurën e likuidimit të saj, sipas dispozitave të Ligjit Tregtar.

17.2. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në perputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund t'i shkarkojë apo zëvendesojë në të njëjtat kushte.

17.3. Administratorët e Shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokurnentet përkatëse.

17.4. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

17.5. Nëse Shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkerisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

17.6. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha vepritneve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyeta e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

17.7. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 (një) vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Ortaku i Vetëm.

17.8. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjatë kësaj procedure, tog-fjaleshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

### Neni 18

#### Të dhëna të detyrueshme gjatë kobëzgjatjes së Shoqërisë

18.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga Shoqëria, degët apo zyrat eventuale të perfaqesimit, nëpërmjet perdorimit të letrës ose e-maileve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- Numrin unik të identifikimit;
- Formën ligjore të shoqërisë;
- Vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qëndrore të saj;
- Të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
- Vlera e kapitalit të regjistruar të shoqerisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

18.2. Nëse Shoqëria krijon edhe një faqe interneti, këto të dhëna do të pasqyrohen aty.

### Neni 19

#### Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

19.1. Ky akt bazohet në legjACIONIN shqiptar dhe interpretimi, vlefshmeria dhe zbalimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjACIONIT shqiptar.

19.2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e legjACIONIT në fuqi, e në veçanti ato të Ligjit Tregtar.

19.3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

#### PËR ORTAKUN E VETËM

Dorina Lamlli 

DORINA LAMLLI